



VENDIM

PËR

DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, SI QIRADHËNËS, DHE FONDACIONIT “FUNDJAVË NDRYSHË”, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE NR.969/15, ZONA KADASTRALE 1263, ME EMËRTIM PRONA NR.98 “GRUP-DEPO, ISH-REPARTI USHTARAK NR.5011”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 16 214 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërise tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3/a, të kreut V, të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me ofertë të pakëruar, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe fondacionit “Fundjavë Ndryshe”, si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr.969/15, zona kadastrale 1263, me emërtimin “Prona nr.98 “Grup-depo, ish-reparti ushtarak nr.5011””, me sipërfaqe të përgjithshme 16 214 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërbëdhjetë) m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 3 138.34 (tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër) m², me vendndodhje në Brar, Tirana, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrotjes, me afat 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të kontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Mbrotjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Shpërndaj

